



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601864/3

Tiranë ___/___/2016

Lënda: Rekomandim për regjistrimin në shkollë të fëmijës E.B.

Drejtuar: Z. Kadri YMERAJ
Drejtor i Drejtorisë Arsimore

Znj. Teuta ÇOKU
Drejtor i Shkollës së Mesme të Përgjithshme "Oso Kuka"

Znj. Rudina KRUJA
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Shkodër

Për dijëni: Znj. Lindita NIKOLLA
Minister i Arsimit dhe Sportit

Tiranë

Znj. Voltana ADEMI
Kryetare e Bashkisë

Shkodër

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është dorëzuar ankesa e fëmijës me inicialet E. B. e cila pretendon se është përjashtuar nga shkolla e mesme e përgjithshme "Oso Kuka", Shkodër nga drejtoresha si rezultat i mungesës së çertifikatës personale.

Në mbështetje të neneve 16 të Kushtetutës ku parashikohet se "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnjë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë" si dhe pikës 3, të nenit 57, të Kushtetutës ku parashikohet se "Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë", dhe në zbatim të nenit 16, të ligjit 10347 datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve", ku parashikohet se "Fëmija ka të drejtë të arsimohet në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor dhe fizik të tij.", çdo fëmijë, gëzon të drejtën për tu arsimuar, pavarësisht problematikës së paraqitur prej saj.

Në zbatim të VKM nr. 266 datë 12.04.2012 "Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" dhe Udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës" si dhe në zbatim

të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar "*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*";

REKOMANDOJMË:

1. Regjistrimin e fëmijës E.B., në shkollën e mesme të përgjithshme "Oso Kuka".
2. Referimin e fëmijës E.B., në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Shkodër për hartimin e planit të mbrojtjes së fëmijës për të mundësuar regjistrimin e fëmijës në gjëndjen civile.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar detyrimi i organeve të administratës për t'ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI

Konc: Matilda Tyli